



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:271705  
Datë: 05.12.2024  
Numri i dokumentit: 06550824

**Në çështjen juridike të :** **AC-I-24-0397-A0001**

*Paditësi*

**F F**, fshati S, Podujevë. me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë.

**Kundër:**

*E paditura/Ankuese*

**N.SH “Zahir Pajaziti”** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2749, të datës 29 prill 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 5 dhjetor 2024, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.
2. Ndryshohet pika 5 e dispozitivit të Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2749, të datës 29 prill 2024 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, nr. PRN046-0236 i datës 26 mars 2014 .
3. Obligohet e paditura që paditësit në emër të pagave të papaguara për muajt mars 2003, janar, shkurt, mars, dhjetor të vitit 2004 dhe janar, shkurt, mars 2005 t'i paguaj shumën prej 1,126.82 euro si dhe interesin ligjor prej 10% në shumën prej 112.40 euro, të cilat do t'i paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit, ndërsa pjesa

tjetër e kërkesës së paditësit për pagat e papaguara për muajt dhjetor 2002, janar dhe shkurt 2003, refuzohet si e pabazuar.

4. Vërtetohet pika 1, 2, 3, 6 dhe 7 e dispozitivit të Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2749, të datës 29 prill 2024.
5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 14 prill 2014, ankuesi kishte dorëzuar në DHPGJS përmes postës së rregullt, zarfin me nr. R-1135129 pa parashtresë në emër të F F, ku ankuesi këtij zarfi i kishte bashkëngjitur tre vendime të Autoritetit të Likuidimit dhe atë: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0234 i datës 26 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensimin e tre pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,048.20 euro për periudhën janar 2006 deri në mars 2006, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit, përkatësisht nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0235 i datës 26 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të paspecifikuar, ishte refuzuar gjithashtu si e pavlefshme për shkak të parashkrimit si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0236 i datës 26 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 1,600.00 euro për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit.

Këtij zarfi përveç tre vendimeve të lartcekura të Autoritetit të Likuidimit i kishte bashkëngjitur edhe këto prova: kopjen e librezës së punës së paditësit, listën e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F për muajin dhjetor 2002, janar-mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004, si dhe janar-mars 2005, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006.

Me 09 dhjetor 2021 Gjyqtari i çështjeje lëshoi një urdhër për paditësin nëpërmjet të cili kërkoi që paditësi brenda 07 ditësh të parashtroi, ankesën ndaj Vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 28 dhjetor 2021, paditësi kishte paraqitur edhe ankesën e tij kundër vendimeve të lartcekura të Autoritetit të Likuidimit dhe atë: PRN046-0234, PRN046-0235 dhe PRN046-0236, të gjithë të datës 26 mars 2014. Në ankesë paditësi kishte theksuar se AKM me datë 24 mars

2006, i kishte dërguar një letër ankuesit me të cilën e kishte njoftuar se “si pasojë e shitjes së aseteve të N.SH-së, është përfundimi i punësimit tuaj për arsye të tepricës dhe kjo letër është njoftim zyrtar për ju se punësimi juaj përfundon menjëherë. Shumat pagat që u janë mbetur borxh, sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur do të fillojnë këto procedura”. Gjithashtu paditësi thekson se i njëjti brenda afatit të paraparë ligjor ka dorëzuar kërkesat e tij kreditore, duke u bazuar në njoftimin e AKP-së për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes dhe afatin e paraqitjes së kërkesave.

Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të miratohet në tërësi e bazuar ankesa e paditësit dhe të anulohet të tre vendimet e AL-së, ashtu që paditësit në emër të kompensimit të pagave të papaguara t’i paguaj shumën e borxhit kryesor prej 1,600.00 euro, duke i njohur edhe tre paga të fundit në shumë prej 1,048.20 euro si dhe kompensimin në emër të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 2,096.40 euro. Gjithashtu të detyrohet e paditura të paguaj interesin ligjor prej 10% dhe shpenzimet e procedurës.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: autorizimin për përfaqësim, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, njoftimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes, listën e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F për muajin dhjetor 2002, janar-mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004, si dhe janar-mars 2005, listën përfundimtare të 20%, kopjen e librezës së punës së paditësit si dhe listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj.

Me datë 31 janar 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Pala kundërshtare konsideron se kërkesat e paditësit do të duhej të ishin paraqitur në ndonjë gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momentin kur N.SH nuk ka përmbushur ndaj parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, që është tre vjet nga koha kur parashtruesi kishte fituar të drejtën për të parashtruar kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara. Andaj e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit dhe të vërtetohen vendimet e

ankimuara të AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e AL-së me nr. PRN046-0234 të datës 26 mars 2014.

Me datë 22 shkurt 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtjen e AKP-së në të cilën i kishte përsëritur pretendimet e tij si në ankesë dhe i kishte propozuar gjykatës që të aprovoj ankesën e tij. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur autorizimin për përfaqësim.

Me datë 4 mars 2022, AKP-ja kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e parashtruar nga paditësi, në të cilën i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj parashtresën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimet e Autoritetit të Likuidimit. Kundërpërgjigjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 29 prill 2024, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2749 kishte aprovuar si të bazuar kërkesën për rishikim të vendimeve të AL-së, ashtu që të njëjtat i kishte shfuqizuar dhe kishte obliguar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit të tri pagave të fundit të papaguara t'i paguaj shumën prej 1,048.20 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8% t'i paguaj shumën prej 83.85 euro, të obligohet e paditura që ankuesit në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës t'i paguaj shumën prej 2,096.40 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8% t'i paguaj shumën prej 167.71 euro. Gjithashtu të obligohet e paditura që ankuesit në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën prej muajit dhjetor 2002 deri në mars 2003, janar-mars 2004 si dhe dhjetor 2004 t'i paguaj shumën prej 1,600.00 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 8% t'i paguaj shumën prej 128.00 euro. Gjithashtu ishte obliguar e paditura që ankuesit t'i paguaj shpenzimet e procedurës. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se në rastin konkret ankuesi ka arritur që të dëshmoj se ka qenë punëtor i N.SH-së në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP-së. Libreza e punës, Lista e punëtorëve, lista e pagave 1 dhe 2 si dhe njoftimi, të gjitha këto prova të parashtruara nga ankuesi argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së deri me datën e privatizimit, respektivisht 24 mars 2006, kohë kjo kur edhe u privatizua N.SH-ja. AKP-ja asnjëherë nuk i ka kundërshtuar shumat e kërkuara nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohohej e drejta në kompensim. AKP-ja faktet nuk i ka kontestuar e për më tepër provat e parashtruara kanë dëshmuar vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Gjykata me rastin e aprovimit të shumës prej 1,048.20 euro në emër të 3 pagave të papaguara është bazuar në listën e pagave nga e cila shihen pagat e

papaguara të mbetura ndaj ankuesit. Nga lista e punëtorëve e publikuar nga AKP-ja shihet se marrëdhënia e punës së ankuesit pranë N.SH-së ishte për rreth 20 vite e 8 ditë. Gjykata sipas listës së pagave konstaton se paga mujore e ankuesit ishte në shumën prej 349.40 euro, e të cilën pagë në pajtim me dispozitën e lartcekur e shumëzoi me 6 paga mujore e që i bie shuma e tërësishme prej 2,096.40 euro (349.40 euro x 6 paga = 2,096.40 euro). Sa i [përket kërkesës së paditësit për pagat e papaguara për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004, gjykata ishte bazuar në listën e pagave nga e cila kishte parë pagat e mbetura të papaguara nga N.SH ndaj ankuesit dhe atë në shumën prej 1,600.00 euro. Andaj, nga të gjitha arsyet e cekura më lartë, gjykata kishte konsideruar se ankuesi kishte arritur të dëshmojë të drejtën në kompensim për kërkesat e lartcekura.

Me datë 21 maj 2024, AKP-ja (e paditura) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-2749 të datës 29 prill 2024 (Aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetojë vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t'i pranojë dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me "Afatin për parashkrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 6 nëntor 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën kishte propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar .

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesat e paditësit për kompensimin e tre pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,048.20 euro për periudhën janar 2006 deri në mars 2006 (PRN046-0234), për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës (PRN046-0235) dhe për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 1,600.00 euro për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004 (PRN046-0236), ishin refuzuar si të pavlefshme nga ana e Autoritetit të Likuidimit për shkak të parashkrimit.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur provat si në vijim: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, njoftimin për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes, listën e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F për muajin dhjetor 2002, janar-mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004, si dhe janar-mars 2005, listën përfundimtare të 20%, kopjen e librezës së punës së paditësit si dhe listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të tre pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,048.20 euro, në emër të ndërprerjes të parakohshme të kontratës së punës shumën prej 2,096.40 euro si dhe në emër të pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004 shumën prej 1,600.00 euro, të gjitha me interes ligjor prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-ja kishte vepruar, pjesërisht drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Kjo për faktin se nga lista e pagave ku paditësi e mban numrin rendor 316 shihet se N.SH i kishte mbetur paditësit borxh në emër të tre pagave të fundit të pa paguara të papaguara shumën prej 1,048.20 euro.

Gjithashtu Njoftimi si dhe libreza e punës konfirmon thënien e tij se të nijetit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së gjegjësit me datën 24 mars 2006, andaj i takon kompensimi për ndërprerjen e Kontratës së punës shumën prej 2.096,40 euro.

Kolegji i Apelit në rastin e vlerësimit të kërkesës për kompensimin e të ardhurave të papaguara për periudhën dhjetor 2002-mars 2003, janar-mars 2004 dhe dhjetor 2004 shumën prej 1,600.00 euro, konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS nuk kishte vepruar tërësisht drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Kjo për faktin se nga lista e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F e lëshuar nga N.SH FAN “Zahir Pajaziti” shihet qartë se N.SH i kishte mbetur borxh paditësit shumën prej 1,638,07 euro në emër të pagave të papaguara, mirëpo një pjese e kësaj kërkesë tashmë ishte parashkruar.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në listën e lartcekur vëren se e paditura i kishte mbetur borxh paditësit për muajt mars 2003, janar, shkurt, mars, dhjetor të vitit 2004 dhe janar, shkurt, mars 2005 shumën prej gjithsej 1.126.82 euro.

Ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, për pagat e papaguara për muajt dhjetor 2002, janar dhe shkurt 2003 refuzohet si e pabazuar për shkak se e njëjta ishte parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi përveç borxhit kryesor kishte kërkuar edhe interesin ligjor. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interesin ligjor prej 10% ose në shumën 112.40 euro

Sipas nenit 42.4 të Ligjit për DHPGJS-në pala e cila pretendon një të drejtë duhet të paraqesë fakte apo prova që provojnë të drejtën e tij, në të kundërtën, faktet e pakontestuar konsiderohen si të vërtetuara.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument përveç parashkrimit me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi si dhe nuk e ka kontestuar asnjë nga shumatat të cilat paditësi i kishte kërkuar.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim për kërkesat si më lartë për periudhën dhe shumat e lartcekura.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës ashtë pjesërisht e bazuar dhe vërtetohet , pjesërisht Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 maj 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 5 dhjetor 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_